



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:300204

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05759229

C.nr.2194/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. (Xh) H. nga fshati Mushtishtë, Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari avokat B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari B.M. nga Prishtina dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson e autorizuar B.M. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 3.100,00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën 14.09.2023 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.H. nga fshati Mushtishtë, Komuna e Suharekës dhe **OBLIGOHET** i padituri i dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë, që në emër të dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara dhe për imazhin e dëmtuar paditësit t'i paguaj shumën prej 30.000,00 euro, si dhe në emër të rrezikshmërisë shumën prej 1.000,00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (14.09.2023), e deri në pagimin definitiv, dhe atë në afatin 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. PJESA TJETËR e kërkesëpadiës së paditësit B.H. nga fshati Mushtishtë, Komuna e Suharekës kundër të paditurit të parë Këshillit Gjyqësor të Kosovës Prishtinë, refuzohet si e pabazuar.

III. Obligohet i padituri i dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës, që paditësit B.H. ti kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën prej 1.308,00 euro, dhe atë në afatin 15 ditor pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.H. nga fshati Mushtishtë, Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarit të tij av. B.K. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka paraqitur padinë kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës- Prishtinë. Në padi ka theksuar se, deri me datën 28.04.2019 ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë Themelore në Prizren- Departamenti i Krimeve të Rënda deri në nxjerrjen e vendimit të komisionit disiplinor KD. Nr.04/2016 të datës 28.04.2016 kur është suspenduar nga detyra e prokurorit. Kundër aktvendimit për suspendim, paditësi ka ushtruar

ankesë, meqenëse procedura disiplinore ishte iniciuar pasi ka kaluar afati i parashkrimit të shkëljes të supozuar disiplinore. Po ashtu ka theksuar se me vendimin e Këshilli Prokurorial të Kosovës nr.245/2016 të datës 07.07.2016 është refuzuar ankesa e parashtruar ashtu që ka ngelur në fuqi vendimi për suspendim i komisionit disiplinor KD.nr.04/2016. Në Prokurorinë Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda kundër paditësit është paraqitur kallëzim penal kinse ka ekzistuar dyshimi se gjatë ushtrimit të detyrës së prokurorit ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i detyrës dhe autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 nën. paragrafi 1 të KPK-së. Gjithashtu ka theksuar se pasi që prokurori i çështjes i ka kryer veprimet hetimore, me qëllim që paditësit ti shkaktohet presion që të tërhiqet nga sistemi prokurorial, ashtu që të eliminohet nga gara si kandidat për zyrën e kryeprokurorit të shtetit dhe të jap dorëheqje nga pozita e prokurorit të Krimeve të Rënda në PTH në Prizren, si dhe i sugjeruar nga zëvendës prokurorja e Kryeprokurorit të shtetit Sevdije Morina me qëllim që procedura të prolongohet sa më shumë, pa dyshim të bazuar në Korrik të vitit 2016 ka marrë vendim për fillimin e hetimeve, pastaj edhe pse nuk ka ekzistuar dyshimi bazuar mirë kundër paditësit, pa mbështetje në prova në Gjykatën Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda është ngritur aktakuzë me dyshim se paditësi ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i detyrës apo autoritetit zyrtar. Për shkak të stresit dhe shqetësimit me datë 25.11.2016 paditësi është paraqitë për vizitë mjekësore në spitalin e përgjithshëm “Daut Mustafa” në Prizren, në ambulancën e Psikiatrisë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 11.11.2020 i autorizuari i paditësit av. B.K. ka bërë precizimin e padisë në kuptim subjektiv, ashtu që si e paditur në këtë rast do të jetë edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditësit av. B.K. ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe deklarimeve në padi, ndërsa në fjalën përfundimtare e parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate me datën 19.09.2023 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ka theksuar se nuk është kontestuese që paditësi për më shumë se 4 vite ka qenë i përndjekur pa të drejtë si prokuror i Krimeve të Rënda me akuza për korrupsion, ku i njëjti me vendimet e të gjitha shkallëve të gjykatave është liruar si i pafajshëm. Gjithashtu ka theksuar se lidhur me dëmin e shkaktuar paditësit më së miri flet ekspertiza e psikiatrisë, në të cilën kanë cekur se, suspendimi nga puna, ngritja e aktakuzës, ankimimet dhe deri në lirim të plotë nga akuzat kanë shfaqur të paditësi efekt të cenimit të integritetit, autoritetit, moral dhe kanë ndikuar negativisht në rrjedhën normale psikosociale të jetës së tij, duke nxitur në këtë mënyrë një gjendje jo të mirë shëndetësore dhe shpirtërore prej të cilës ankth, pasiguri mërzi, vështirësi etj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 2505 euro, dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 312 euro, për taksën gjyqësore shumën prej 21 euro, për ekspertizën psikiatrike shumën prej 150 euro, për ekspertizën financiare shumën prej 150 euro, për 6 seanca të mbajtura me nga 312 euro.

E paditura e parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, për kompensimin e dëmit jo material për shkak të ngritjes së aktakuzës nga Prokuroria e shtetit t’ia paguaj shumën prej 98.000.00 €. Sipas tyre KGJK përmes UA 04/2015 për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye, nuk parashihet kompensim dëmi për shkak të zhvillimit të procedurës penale. Siç detyrohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, KGJK ka hartuar këtë udhëzim, i cili në mënyrë të drejtuar parashihet rastet e kompensimit, si dhe sipas këtij udhëzimi dhe Kodit të Procedurës Penale, lejohet vetëm kompensimi për privim të paarsyeshëm nga liria, më gjerësisht si në përgjigje në padi nga e paditura e parë.

Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor i autorizuari i paditurës së parë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, B.M. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve të mëhershme. Në fjalën përfundimtare e dorëzuar me shkrim pranë kësaj gjykate me datën 18.03.2023 ka theksuar se mbetet në tërësi pranë thënieve në padi dhe gjatë seancave paraprake, si dhe procedura e kompensimit të dëmit për personat ndaj të cilëve zhvillohet gjykimi i paarsyeshëm dhe personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye, rregullohet me ligj të veçantë, saktësisht me dispozitat e Kapitullit XXXVI të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në bazë të dispozitave të kapitullit XXXVI të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht nenit 525 dhe 529, të drejtë kompensimi kanë vetëm personat të cilët në çfarëdo forme padrejtësisht janë privuar nga liria, apo personat me vendim përfundimtar janë shpallur fajtor ose u është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë, por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë, ose është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar. Gjithashtu kanë theksuar se nga provat të cilat i posedon e paditura, vërehet se paditësi në asnjë moment nuk ka qenë i privuar nga liria, ose në arrest shtëpiak apo në paraburgim. Gjithashtu edhe duke u bazuar në shkresat e lëndës shihet se Aktakuza është ngritur nga Prokuroria Themelore- Departamenti për Krime të Rënda PP/1 nr.3156/2016 e datës 23.09.2016, ndërsa Gjykata Themelore në Prizren PKR.nr.270/2016 të datës 11.06.2018 ka marrë Aktgjykim ku lirohet nga akuza paditësi, po ashtu Gjykata e Apelit e Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda PPAKR.nr.529/18 të datës 10.12.2018, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore DKR në Gjilan, kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore DKR në Gjilan, PKR.nr.270/16 e datës 11.06.2018 e ka vërtetuar. Gjykatës i kishte propozuar që kërkesë padinë e paditësit të refuzoj në tërësi si të pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit real pasiv në procedurë në raport me KGJK-ën dhe për shkak të mungesës të bazës juridike.

E paditura e dytë Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.H. nga fshati Mushtisht, Komuna e Suharekës.

Edhe i autorizuari i të paditurit të dytë B.M. gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e dorëzuar me shkrim pranë kësaj gjykate ka theksuar se, pas administrimit të provave, deklarimeve në seancat paraprake, mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi për kundërshtimin e padisë. Kanë theksuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në procedurë, për arsye se legjitimiteti real është marrëdhënie e palëve të sajuara në bazë të ndonjë raporti juridiko civil nga e cila rrjedhin të drejtat subjektive dhe me rastin e cenimit të tyre, titulluari i së drejtës subjektive të cenuar, ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore të së drejtës subjektive të cenuar, e që në rastin konkret prokurori i shtetit nuk ka qenë në ndonjë raport juridiko civil me paditësin mirëpo prokurori i shtetit ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësit e tij të parapara me Kushtetutë. Po ashtu i kanë kundërshtuar edhe ekspertizat financiare dhe psikiatrike. Andaj gjykatës i kanë propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj si të pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Gjilan Departamenti i Krimeve të rënda si gjykatë shkallës së parë me numrin PKR.nr.270/2016 të datës 11.06.2018 plotfuqishëm me datën 10.12.2018, lexohet aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamenti për krime të rënda me numrin PAKR.nr.529/18 të datës 10.12.2018, aktgjykimin Gjykatës Supreme të Kosovës me numrin Pml.nr.35/2019 të datës 13.03.2019, dekretin me numrin e dekretit DP-022-2018 lëshuar nga

Presidenti Republikës së Kosovës me datë 16.04.2018, ekspertiza e punuar nga eksperti gjyqësor financiar Isak Krasniqi nga Prizreni të datës 31.05.2023.

Gjykata, pas vlerësimit të theksimeve të paditësit dhe provave të administruara veçmas secilën, veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata ka konstatuar se kërkesë padia e paditësit është **pjesërisht e bazuar**.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda, me nr. PKR.nr.270/2016 të datës 11.06.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi B.H. nga fshati Mushtisht, Komuna e Suharekës, është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK-s, ngase nuk është provuar se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Vendimi ky i cili është bërë plotfuqishëm me datën 10.12.2018.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda, me nr. PAKR.nr.529/18 të datës 10.12.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore- DKR në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore- DKR në Gjilan, PKR.nr.270/16, të datës 11.06.2018, është vërtetuar.

Nga leximi i aktgjykimi e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. Pml.nr.35/2019 të datës 13.03.2019, gjykata ka vërtetuar se është refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, e paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.270/2016 datë 11.06.2018 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.529/18 datë 10.12.2018.

Nga leximi i dekretit me numrin DP-022-2018 e lëshuar nga Presidenti Republikës së Kosovës me datë 16.04.2018, gjykata ka vërtetuar se B.H. prokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren, lirohet nga detyra për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit B.H. nga fshati Mushtisht, Komuna e Suharekës, është **pjesërisht e bazuar**.

Baza ligjore

Me nenin 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Si dhe sipas nenit 183 par. 1 i cili parasheh që “Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet e pësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material” ndërsa në par. 2 parashihet që “me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe*

me qëllimin shoqëror” sipas nenit 173 par. 1 të LMD-së i cili parasheh që “I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”. Po ashtu në nenin 525 të Kodin e Procedurës penale është paraparë se “Të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar...” ndërsa neni 529 të po këtij Kodi është paraparë se “E drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu: 1.1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar”. Në nenin 526 të KPP-së po ashtu është paraparë se “E drejta për kompensim dëmi parashkruhet tri (3) vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuar është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza ose pushohet procedura. Kur për ankesë vendos gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas tri (3) vitesh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi sipas vendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda, me nr. PKR.nr.270/2016 të datës 11.06.2018, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 parag.1 të KPPK-së, vendim ky që i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 10.12.2018. Po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e Kosovës- Departamenti i Krimeve të Rënda është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore – DKR NË Gjilan, PKR.nr.270/16 të datës 11.06.2018, është vërtetuar. Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësit a i takon kompensimi i dëmit ashtu siq edhe ka kërkuar me anë të kërkesëpadisë.

Nga provat e administruara të cekura sikurse më lart dhe nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse gjykata ka ardhur në përfundim se padia e paditësit është pjesërisht e bazuar andaj ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata ka vërtetuar se paditësi është deri me datën 28.04.2019 ka ushtruar funksionin e prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Prizren- departamenti i Krimeve të Rënda, deri sa sipas vendimit të komisionit disiplinor KD. Nr.04/2016 të datës 28.04.2016 është suspenduar nga detyra e prokurorit. Andaj ndaj këtij vendimi paditësi ka ushtruar ankesë për shkak se procedura disiplinore ishte iniciuar pasi kishte kaluar afati i parashkrimit të shkeljes të supozuar disiplinore, mirëpo me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës nr.245/2016 të datës 07.07.2016 është refuzuar ankesa e parashtruar ashtu që ka mbetur në fuqi vendimi për suspendimin i komisionit disiplinor KD/nr.04/2016. Po ashtu në korrik të vitit 2016 paditësi ka marrë vendim për fillimin e hetimeve. Më vonë me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan –Departamenti i Krimeve të rënda PKR.NR.270/2016 e datës 11.06.2018, paditësi është liruar nga akuza për shkak të veprës penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Nga provat e administruara përkatësisht ekspertizës së ekspertit të psikiatrisë dr. N.M. F.të datës 13.01.2023 (të cilës gjykata ia fal besimin e plotë), është konstatuar se për shkak të suspendimit nga puna, ngritja e aktakuzës, gjykimi, ankesat dhe deri në marrjen aktgjykimit lirues, paditësi kishte përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë për 3

muaj, intensitetit të mesëm 3 muaj dhe dhimbja shpirtërore e intensitetit të ultë ka zgjatur deri në përfundimin e procedurës penale kundër paditësit.

Si pasojë e vendimeve të lartcekura paditësi kishte përjetuar dhimbje shpirtërore për privim nga liria dhe për shkak të imazhit të humbur në shoqëri. Duke marr parasysh këto dhimbje, kohëzgjatjen dhe natyrën e tyre si dhe vepra penale e cila i është vër në barë gjykata ka konstatuar se shuma e caktuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të shërbej si satsafksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po që se të njëjtat nuk do t'i kishte humbur si pasoj e zhvillimit të procedurës penale ndaj tij, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e dëmit të shkaktuar tek paditësi, dhimbje shpirtërore, dhimbje shpirtërore për cenimin e imazhit etj.

Gjykata duke vlerësuar dëmin jo material të shkaktuar te paditësi ka konstatuar se dhimbjet shpirtërore për shkak të gjykimit të pabazë, paraqet një formë të dëmit, i cili përfshinë të gjitha pasojat e dëmit jo material të lidhur me personalitetin e të dëmtuarit e që rezultojnë me dhimbje shpirtërore, gjykata ka caktuar shumën e kompensimit si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi duke marrë për bazë rrethanat e rastit, autoritetin dhe respekti që ka pësuar i dëmtuari në mesin ku ka jetuar dhe tani jeton para, pesha dhe natyra e veprës penale e cila i është vërë në barrë si dhe të gjitha rrethanat tjera që kanë ndikuar në natyrën dhe peshën si dhe zgjatjen e dhimbjeve shpirtërore.

Gjykata e refuzoi në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit ndaj të paditurit së parë Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës (KPK-së), për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të tij. Kjo pikërisht për arsye se sipas dispozitës së nenit 109 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 7 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, me të cilat dispozita ligjore parashikohet autorizimet dhe përgjegjësi e Prokurorit të Shtetit për ndjekjen penale të personave të akuzuar për veprë penale. Përpos kësaj sipas dispozitës së nenit 529 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës parashikohet e drejta e kompensimit të dëmit për personat për privim pa bazë nga liria. Sipas kësaj dispozite ligjore paditësja ka paraqitur padi kundër të paditurit të parë KGJK-së, si organ që ka legjitimitet pasiv materialo juridik. Po ashtu kjo mungesë të legjitimitetit vërtetohet edhe nga fakti se e paditura e dytë apo organet kompetente të saj mund të bëjnë vetëm propozime për caktimin e masave të ndryshme sikurse është paraburgimi, ndërsa vendime në lidhje me këto kërkesa vendos Gjykata kompetente. Andaj, të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës i mungon legjitimiteti pasiv në rastin konkret dhe si të tillë kërkesëpadija e paditësit ndaj të paditurit të parë, gjykata e kishte refuzuar si të pa bazuar.

Po ashtu gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në lidhje me fitimin e humbur për shkak të humbjes së vendit të punës dhe trustit pensional, pasi që paditësi me asnjë provë të vetme materiale nuk e ka dëshmuar faktin se kishte mbetur pa vendin e punës apo aq më shumë se kishte mbetur pa vendin e punës për shkak të zhvillimit të procedurës penale apo për shkak të arrestimit të pa arsyeshem të tij, apo se nuk ka mundur të punësohet për shkak se kundër tij është në zhvillimin e sipër procedura penale. Po ashtu nuk është vërtetuar fakti se paditësi për shkak të zhvillimit të procedurës penale nuk ka mundur të aplikoj në tenderë publik, pasi që me asnjë provë të vetme materiale nuk e ka vërtetuar faktin se kishte aplikuar në ndonjë tender apo aq më shumë se i është refuzuar aplikimin në tender të caktuar për shkak të zhvillimit të procedurës penale kundër tij. Është i vërtet fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune tek Ndërmarrja Shoqërore "Gjeodezia" në Gjakovë dhe më vonë sipas kontratës së punës kishte krijuar marrëdhënie pune me komunën e Gjakovës, ku ishte bërë Udhëheqës i Sektorit për

Kadastër dhe Gjeodezi pranë komunës së Gjakovës, kontratë kjo e cila kishte pushuar për shkak të përfundimit të kohëzgjatjes së të njëjtës, pasi që është lidhur në afatin të caktuar kohor nga 01.04.2005 e deri më 30.09.2005 (gjë e cila mund të konstatohet nga kontrata mes komunës dhe paditësit me nr.60 të datës 01.04.2005), e jo për shkak të zhvillimit të procedurës penale apo privimit të pa arsyeshëm nga liria. Ndërsa me njoftimin e komunës së Gjakovës me nr. 375/2005 të datës 01.09.2005, mund të konstatojmë se paditësit i është ndërprerë vazhdimi i më tejme i kontratës për shkak se kishin pushuar arsyet dhe nevojat që të vazhdohet më tutje me kryerjen e këtyre punëve, e jo siç thekson paditësi në padinë e tij si pasoj e zhvillimit të procedurës penale kundër tij. Sipas mendimit të kësaj gjykata fitimi i humbur konsiderohet fitim i cili në bazë të rrethanave objektive, me arsye dhe me bazë ka mundur të pritët qoftë sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave, qoftë sipas rrethanave të veçanta që kanë ekzistuar e të cilat do ta mundësonin atë. Pra, është ai fitim i cili nga rrjedha e zakonshme e gjërave në bazë të rrethanave objektive është mundur të pritët apo se do të kishte ndodh, pa veprimin e shkaktarit të dëmit, e që në rastin konkret janë vendimet e të paditurës së parë. Andaj, nuk mund të konsiderohet fitimi i humbur ai fitim i cili sipas vlerësimeve subjektive paraqitet se do të ndodhte, po që se një gjë e tillë nuk mund të pritët edhe nga rrethana objektive.

Gjykata kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sa i përket pagimit të shpenzimeve për mjekim në shumën prej 1000 euro, pasi që paditësi, gjykatës nuk ia kishte dorëzuar asnjë provë të vetme materiale, me të cilët do të dëshmohet se sa shpenzimet i kishte pësuar paditësi gjatë kohës të mjekimit të tij. Mbi bazën e të lartcekurave dhe duke qenë se paditësi nuk i ka ofruar gjykatës prova të mjaftueshme dhe bindëse, përmes të cilave do të argumentohet se sa janë në të vërtet shpenzimet e tij gjatë kohës të mjekimit, edhe pse për këtë në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi është ftuar nga ana e gjykatës që të propozoj prova të reja, pasi që sipas nenit 7.1 të LPK-së të lartë cituar, *onus probandi* lidhur me pretendimet e tij, i takon atij (pra paditësit), e jo të paditurit apo gjykatës, kjo e fundit gjeti se nuk ka bazë për aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit në lidhje me këtë kërkesë, respektivisht të njëjtën e refuzojë si të pabazuar.

Gjykata e ka refuzuar propozimin e paditësit që në këtë çështje kontestimore të mirët prova përmes ekspertizës financiare pasi që ka gjetur se fillimisht për tu caktuar një ekspertizë e tillë gjykata duhet të bindet se paditësi ka një bazë të arsyeshme se kishte pësuar një dëm të tillë. Nga provat e cekura si më lartë (kontratën e punës, njoftimin për ndërprerje të kontratës etj.), gjykata ka konstatuar se fare nuk ka nevojë të merret kjo ekspertizë për faktin se paditësi me asnjë provë të vetme materiale nuk ishte provuar faktin se ai me të vërtet kishte bazë për fitimin e humbur me të cila gjykata përmes ekspertizës do të kishte konstatuar se sa ne të vërtet ishte ky fitim. Gjykata përkujton se eksperti mund të caktoj eventualisht se sa ishte fitimi i humbur i paditësi (duke e llogaritur atë sipas vendimit të gjykatës), e jo të përcaktoj bazë se paditësit në rastin konkret a i takon e drejta në kompensim për këtë bazë apo jo, gjë të cilën e përcakton gjykata. Për deri sa me prova materiale paditësi nuk e kishte bindur gjykatën se i takon e drejta sipas kësaj baze, gjykata nuk e kishte parë të arsyeshme të caktoj një ekspertizë të tillë dhe si pasojë të kësaj edhe e kishte refuzuar propozimin e paditësit. Me të njëjtën arsye gjykata e kishte refuzuar edhe propozimin e paditësit që si provë të administrohet ekspertiza financiare të cilën pala paditëse e kishte bërë me vet iniciativ dhe pa vendim të gjykatës dhe atë pasi që gjykata në shqyrtimin gjyqësor e kishte refuzuar propozimin e paditësit për marrjen e provës përmes ekspertizës financiare.

Gjykata vlerësoj pretendimet e të paditurës në lidhje me atë se gjykata në lidhje me përcaktimin e lartësisë së kompensimit të vendosë sipas udhëzimit administrativ 04/2015 të KGJK-së, por gjykata të njëjtat pretendime nuk i mori për bazë pasi që i njëjti Udhëzim

Administrativ në nenin 13.4 parasheh që nëse pala nuk pajtohet me shumën e ofruar nga ana e komisionit, ajo duhet të nënshkruaj këtë mospajtim dhe me këtë fiton të drejtën që në procedurën e rregull gjyqësore, me padi civile të kërkojë kompensimin e dëmit për të cilën pala pretendon se i takon. Në rastin konkret paditësi ka vepruar sipas udhëzimit, por nuk është pajtuar me shumën e ofruara për kompensim nga komisioni dhe kjo vërtetohet nga ofertën e dhënë nga e paditura dhe me paraqitjen e padisë pranë gjykatës. Ndërkaq sa i përket pretendimeve tjera e të paditurës, sa i përket standardit jetësorë në Kosovë, për gjykatën është irelevante dhe nuk ka ndikim në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Pretendimet e të autorizuarit të paditurës së parë në lidhje me parashkrimin e kërkesës për kompensim, gjykata i ka vlerësuar si të pabazuar pasi që bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë e drejta për paraqitjen e kërkesës parashkruhet pas kalimit të 3 viteve nga momenti pasi që vendimi në procedurën penale të bëhet i plotfuqishëm, e që në rastin konkret vendimi me të cilin paditësi ishte liruar nga akuza ishte bërë i plotfuqishëm me datën 19.11.2014, ndërsa padia në gjykatë është parashtruar me datën 04.01.2017, apo brenda afatit ligjor të paraparë.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, në të cilat janë përfshirë, në emër të taksës shumën prej 21 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 312 euro, për përfaqësimin e paditësit në 5 seanca gjyqësore shumën prej 675 euro, në emër të ekspertizës psikiatrike shumën prej 150 euro dhe në emër të ekspertizës financiare shumën prej 150 euro, apo gjithsejtë shumën e përgjithshme prej 1308 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2194/19 me datë 14.09.2023

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.